



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.183 dt.24.12.1998

**PER
MIRATIM FONDI PER VIZITEN E ANTAREVE TE
KESHILLIT BASHKIAK NE TURQI DHE SELANIK.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.24.12.1998, pasi mori në shqyrtim propozimin e një grupi këshilltarësh për të bërë një vizitë pune dhe eksperience në Bashkinë e Stambollit dhe brenda mundësive dhe në Bashkinë e Selanikut propozojnë për këtë qëllim miratimin e një fondi për përballimin e shpenzimeve që nevojiten për vizitën e antarëve të Këshillit Bashkiak e mbështetur kjo kërkesë në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”

VENDOSI

1. Të miratojë realizimin e vizitës së punës të antarëve të Këshillit Bashkiak në Bashkinë e Stambollit.
2. Të miratojë fondin prej 22.100 dollarë(USA) nga të ardhurat e Bashkisë për shpenzimet e nevojshme për vizitën e antarëve të Këshillit Bashkiak në Stamboll.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Organizim Personelit e Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI